



REPubLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/_____

Datë: 05.06.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 10, nenit 23, nenit 35 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/411 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IV- (katërt) të rregullt të mbajtur me datë: 30.05.2024 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI,
MIRËQENIE SOCIALE DHE PERSONA ME AFTËSI TË VEÇANTA.

1. Miratohet Raporti i punës nr.02/198 datë:08.05.2024, i Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023.
2. Raporti i punës përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e organizuara për vitin 2023, nga Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Raporti i punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta, për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kuvendit të Komunës së Malishevës

Kryesuesit z.Argjend Thaçi

CC: Kryetarit të Komunës z.Ekrem Kastrati.

Datë: ___/___/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI KOMUNËS
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVA



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO

N. N. D.

08/05/2024
02/198

Lënda: Raporti i Punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Duke vepruar sipas Vendimit me të cilin Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka themeluar komitetin jo obligativ "Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta" po ju paraqesim në mënyrë përmbledhëse, punën që ky komitet ka kryer për vitin 2023.

Ne, aktivitetet tona i kemi bazuar në planin e punës së miratuar nga ana e juaj, dhe që ka përfshirë vitin 2023, plan të cilin e ka miratuar edhe Kuvendi i Komunës së Malishevës, natyrisht në bazë të propozimit të komitetit. Që në mbledhjen e parë kemi filluar punën e hartimit të planit të punës, i cili është prezantuar para jush për miratim, dokumenti me titull "Plani i Punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, kemi mbajtur gjithsejtë, 7 vizita të komitetit, ku pas miratimit të Planit të punës kemi pasur këto aktivitete:

Gjithashtu gjatë vitit 2023, kemi mbajtur 6 mbledhje të rregullta të komitetit.

Gjatë takimeve zyrtare, kemi shqyrtuar mundësin e ngritjes së çështjeve relevante si dhe përgatitja dhe adresimin e rekomandimeve, për organet kompetente,

Vizitë ne DSHMS, me datë , 17.03.2023,u informuam për punë e përditshme në drejtori dhe QKMF. Edukimi i vazhduar profesional është një proces i cili duhet të vazhdojë me qëllim të shtimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Në vazhdim kemi biseduar për mobilizimin permanent të institucioneve shëndetësore, për zvogëlimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID 19, si dhe angazhim për minimizimin e rreziqeve nga epidemia Ethet Hemorragjike- Krime Kongo. Në

vazhden e kesaj si komitet do te angazhohemi qe te shqyrtohen mundesit ligjore qe ne kuader te QKMF-se, te ketë dy specializime, Infektologjia dhe një mjek specialist për mjekësi emergjente.

Vizite në Qendrën për Punë Sociale, me datë ,20.07.2023,ku kemi parë perseafërmi shërbimet që i ofron kjo qendër sidomos për kategoritë e ndjeshme. U informuam se shfrytëzues të ndihmave sociale janë 600 ekonomi familjare. Raportet me nivelin qendrorë dhe atë lokal janë të kënaqshme.

Gjithashtu kemi vizituar dhe takuar stafin e Hendikos-dega në Malishevë, ku jemi njoftuar me punën, sfidat dhe kërkesat që ka kjo shoqatë, për trajtimin e personave me nevoja të veçanta, që është edhe fokus i këtij Komiteti, sidomos kategorinë e fëmijëve. Ishte kërkesë për të ja siguruar një automjet për nevojat e Hendikos-dega në Malishevë.

Kemi vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatin Kijevë, ku jemi njoftuar me ecurinë e punëve të kesaj qendre në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke pasur parasysh edhe qasjen e popullatës në këto shërbime, ngase pjesa ma e madhe janë banorë të komunave tjera për rreth. U kërkuar objekt i ri i QMF-se, në këtë fshat, sepse objekti ekzistues nuk i plotëson kushtet e duhura për punë.

Gjatë këtij viti kemi pasur edhe vizite në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Bellanicë,, ku jemi njoftuar ne si komitet për rrjedhën e punës së kesaj qendre në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Gjithashtu duke parë rëndësinë e punës dhe shërbimeve që kryen për qytetarët e komunës së Malishevës, kemi pasur vizite zyrtare edhe në njësinë e Hidroregjionit Jugor në Malishevë. Në këtë njësi, kemi marrë informata të detajuara se si bëhet furnizimi si dhe sfidat që kjo njësi, ku ka mungesë të ujit të mjaftueshëm për furnizim të gjitha fshatrave, sidomos gjatë stinës së verës. Në Hidroregjion u interesuam për kualitetin e ujit të pijes, sasisë dhe ekzaminimeve të ujit të pijes, fjala është për analizat kimike, fizike dhe mikrobiologjike të ujit të pijes, punë kjo e cila duhet të jetë permanente, me qëllim që të ruhet shëndeti i qytetarëve.

Në kuader të aktiviteteve tona të planifikuara ne kemi pasur takime zyrtare edhe me Zyrtarët e njësisë së Ekoregjioni-njësia në Malishevë, ku kemi marrë informata të vlefshme se si bëhet grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale të amvisërive dhe bizneseve në komunën e Malishevës, si dhe rolin që kjo kompani luan në mirëmbajtjen e ambientit që ka një rëndësi shumë të madhe në shëndetin publik.

Vijueshmëria e anëtarëve të komitetit ka qenë e rregullt në përbërje të plotë dhe konform përgjegjësisë të deleguara e vendimin e kuvendit të komunës së Malishevës.

Duhet të potencojë se kontributi i anëtarëve të këtij komiteti ka qenë përmbajtësor, duke pasur parasysh niveli i përgatitjes profesionale sikur kërkohet edhe me vendim, ishte në kryerje të detyrës së kërkuar. Ne gjithashtu kemi planifikuar takime edhe me kryetarin e komunës, mirëpo për shkaqe të agjendave të ngjeshura të kryetarit si dhe pamundësisë tonë për takime të shpeshta, nuk kemi mundur që të realizojmë një takim zyrtar, ndërsa shpresojmë se ky takim do të realizohet në këtë vit. Gjithashtu sfidë ka qenë edhe mos pagesa e mëditjeve për anëtarët e komiteti duke ditur se ata kanë pasur shpenzime shtesë për vajte ardhje në takime zyrtare. Një tjetër kërkesë e Komisionit ka qenë edhe është edhe pjesëmarrja jo e rregullt e zyrtarëve të zyrës për informim publik.

Gjatë vitit 2023, ne gjithashtu kemi dhënë rekomandime për organet vendimnarrëse,

për ndarjen e mjeteve financiare si ;

1. Edukimin në rrafshin e ultrasonografisë shuma prej 5,000.00 € për 4 mjek,
2. Financim të shpenzimeve të rrugës, për stafin shëndetësor në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, të cilat duhet të kryhen në QKUK-Prishtinë edhe atë shumën prej 2,000.00 €, për trajnimin e 30 infermierëve.

Komiteti për Shëndetësi , Mirëqenie Sociale si dhe Persona me Aftësi të Veçanta është në përbërje prej;

Anëtarët e Komitetit:

1. Dr.Aziz Thaqi, NISMA-Kryesues
2. Urim Thaqi, NISMA-anëtar
3. Dr. Drilon Gashi, PDK- anëtar
4. Dr. Gafurr Hoti, LDK- anëtar,
5. Faton Lushtaku, V.V-anëtar.



Malishevë, me dat,..../..../2024